

SHKURT 2026

# BULETINI



## Panel Diskutimi “Të Drejtat e Punës dhe Punësimi

Më 24 shkurt 2026, OJQ ACDC organizoi një diskutim publik në panel në Shtëpinë e BE-së në Mitrovicën e Veriut mbi të drejtat e punës dhe mbrojtjen institucionale. Ngjarja u zbatua në kuadër të projektit “Justice@Work”, i financuar nga Fondi për Zhvillim të Komunitetit (CDF) përmes programit Human Rightivism, me mbështetjen e Sida-s. Panelistët përfshinin Laura Mustafa Berishën, Kryetare e Divizionit të Mbikëqyrjes së Inspektimit në rajonin e Mitrovicës; Srxhan Sentiq, Zëvendës Avokat i Popullit; dhe Nebojsa Vllaijiq, avokat.

U konkludua se përparim domethënës kërkon koordinim më të fortë institucional, rritje të kapaciteteve të Inspektoratit të Punës, përmirësim të qasjes gjuhësore në institucionet publike, si dhe zbatim të qëndrueshëm të rekomandimeve të mekanizmave të pavarur të mbikëqyrjes, për të siguruar qasje efektive, të barabartë dhe substanciale në drejtësi për punëtorët në veriun e Kosovës.



Brenda projektit, u zhvillua një Udhëzues praktik përmes të Drejtave të Punës në Kosovë, i destinuar për të rinjtë dhe punëtorët e tjerë, duke ofruar informacion të qartë mbi të drejtat dhe mekanizmat mbrojtës të disponueshëm. Udhëzuesi është i disponueshëm në faqen e internetit të OJQ ACDC.



SRB



ENG



ALB



## Tryezë e rrumbullakët mbi përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Prishtinë

Prishtinë, 20 shkurt 2026 – Në Hotel “Sirius” u mbajt tryezë e rrumbullakët kushtuar përmirësimit të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve jo-shumicë dhe forcimit të mekanizmave institucionalë për zbatimin efektiv të tyre. Ngjarja u organizua bashkërisht nga OJQ ACDC dhe Institucioni i Avokatit të Popullit, me mbështetjen e UNMIK-ut, me qëllim hapjen e dialogut ndërmjet përfaqësuesve institucional dhe organizatave të shoqërisë civile mbi gjendjen e të drejtave të komuniteteve, sfidat në realizimin e tyre dhe mundësitë për të përmirësuar mekanizmat mbrojtës.

Avokati i Popullit Naim Qelaj theksoi se gati një e pesta e ankesave të paraqitura gjatë vitit 2025 erdhën nga anëtarë të komuniteteve jo-shumicë — 325 nga një total prej 1,736 ankesash. Ankesat më të shpeshta kishin të bënin me të drejtat gjuhësore, përfaqësimin në institucione, qasjen në drejtësi, qasjen në dokumente, të drejtat e pronës dhe kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore.



## Trajnimi interaktiv për të rinjtë

Në kuadër të projektit “Fqinjët e Gjelbër, u organizuan aktivitete interaktive gjatë të cilave të rinjtë nga Mitrovica e Veriut dhe Mitrovica e Jugut diskutuan për mbrojtjen e mjedisit, veprimet e përbashkëta ekologjike dhe rëndësinë e angazhimit qytetar. Përmes diskutimeve të hapura dhe shkëmbimit të ideve, u nxit besimi i ndërsjellë dhe pjesëmarrja aktive e të rinjve në përmirësimin e komunitetit dhe bashkëjetesës.

Theks i veçantë iu kushtua zhvillimit të iniciativave lokale dhe nxitjes së angazhimit afatgjatë të të rinjve në çështjet e mbrojtjes së burimeve natyrore. Projekti mbështetet nga BOOST Balkans dhe zbatohet nga Education Code dhe ACDC.

## Punëtori Edukative mbi Mbrojtjen e Burimeve Ujore

Një punëtori edukativ kushtuar mbrojtjes së burimeve ujore dhe ruajtjes së mjedisit u mbajt në ambientet e OJQ ACDC gjatë shkurtit. Përmes trajnimit praktik dhe interaktiv, pjesëmarrësit zgjeruan njohuritë e tyre rreth mbrojtjes së lumenjve, sfidave me të cilat përballlet komuniteti lokal dhe rolit të qytetarëve në ruajtjen e burimeve natyrore.



Seminari u zbatua në kuadër të programit IWRM-K të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Qeverisë së Kosovës, i realizuar nga Skat Consulting Ltd. (Zvicër) në konsorcium me Agjencinë Austriake të Mjedisit (EAA). Projekti zbatohet bashkërisht nga OJQ ACDC dhe OJQ REC.

## Punëtori mbi bashkëpunimin e të rinjve për hapësirat e gjelbra publike

Në kuadër të projektit “Fara e Bashkëpunimit”, ACDC organizoi punëtori me të rinjtë nga Mitrovica e Veriut dhe Mitrovica e Jugut me qëllim forcimin e njohurive për mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e mendimit kritik dhe zhvillimin e përgjegjësisë qytetare. Punëtoritë vendosën bazën për fazën e ardhshme të projektit – krijimin e kopshteve urbane multietnike dhe zbatimin e veprimeve të përbashkëta në komunitet.



Fokusi i aktiviteteve ishte lidhja e të rinjve nga komunitete të ndryshme përmes punës së përbashkët në përmirësimin e hapësirave të gjelbra publike. Projekti realizohet me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe CARE Deutschland e.V.

## ACDC vazhdon trajnimet mbi të drejtat pronësore dhe sociale në veri të Kosovës



Gjatë muajit shkurt, ACDC vazhdoi të organizojë trajnime për të rinjtë mbi të drejtat pronësore dhe sociale në të gjithë veriun e Kosovës. Qëllimi i trajnimit ishte t'u ofrojë të rinjve njohuri praktike për orientim në kornizat ligjore që lidhen me pronën, të drejtat sociale dhe komunikimin me institucionet përkatëse, në mënyrë të informuar dhe të përgjegjshme. Aktivitetet u realizuan me mbështetjen e ATRC-së.

## ACDC në media

Drejtori i Programit Aleksandar Rapajiq foli për “Insajder” rreth pasigurisë ligjore dhe shqetësimeve ndërmjet serbëve në Kosovë në kontekstin e zbatimit të shpallur të ligjeve dhe vendimeve institucionale.



Drejtori i Programit Aleksandar Rapajiq komentoi për “Kosovo Online” mbi zhvillimet aktuale politike dhe qëndrimet ndaj iniciativave rajonale për paqe dhe bashkëpunim.












Zyrtarja e Programit Ines Aljoviq Mihajloviq foli për “Kosovo Online” rreth gjetjeve të hulumtimit mbi ngacmimin seksual.



Në një artikull për “Telegrafi”, Zyrtarja e Programit Ines Aljoviq Mihajloviq potencoi se si gratë nga komunitetet jo-shumicë mund të tejkalojnë barrierat dhe të arrijnë ndikim më të madh në vendimmarrjen politike në Kosovë.



-  [www.acdc-kosovo.org](http://www.acdc-kosovo.org) 
-  [office@acdc-kosovo.org](mailto:office@acdc-kosovo.org) 
-  [www.facebook.com/Ngoacdc](https://www.facebook.com/Ngoacdc) 
-  [www.instagram.com/acdc.kosovo](https://www.instagram.com/acdc.kosovo) 
-  [www.x.com/ngo\\_acdc](https://www.x.com/ngo_acdc) 